



Un Dentista per Amico  
ArKe`Onlus

## **RREGULLAT E NDIHMËS DENTARE FALAS PËR TË MITUR QË IU PERKASIN FAMILJEVE TË BRISHTA TE VARURA NGA RRETHET SOCIALE DHE SHENDETESORE**

**Projekti DxA – Një Dentist për Mikofron** kura dentare konservatore falas për të mitur me aftësi të kufizuara ekonomike të përfshirë në komunitete strehimi, qendrat socio-educative, struktura të mbrojtura (që tani e tutje quhen si struktura) nëpërmjet përdorimit të punës falas dhe vullnetare të dentistave e ortodontave.

Pranë DxA, ekziston projekti **ASSO-Shkolla e shëndetit oral** dhe ushqimit të shëndetshëm që ofron mesim për shëndetin oral dhe në përgjithësi këshilla për mënyren korrekte të jetesës sepse parandalimi është çelësi i mesazhit tonë.

Arkè është OdV (organizatë vullnetare) e cila ka autorësinë e projektit, e fonduar në vitin 2000 dhe është unik në nivelin kombëtar.

Kjo rregullore ndjek linjat themelore të përshkruara në marrveshjen që Arkè ka nënshkruar me rajonin Liguria në vitin 2013 dhe që shërben si reference për marrëveshje me rajone të tjera.

### **SI TE AKTIVIZONI PROJEKTIN:**

Rrethi socio- shëndetësor merr përsiper për të përhapur ekzistencën e projektit për të gjitha familjet, që kanë dhe nuk kanë kujdestarin e fëmijëve të mitur, nëpërmjet **informacionit** të paracaktuar nga shoqata Arkè.

Çdo punonjës social i çdo ATS, pasi verifikon gjendjen e vërtetë të skamjes dhe besueshmërisë të aplikantit, do të dërgoj shoqatës Arkè me e-mail/ fax **lejone** plotësuar dhe të nënshkruar nga prindi/ tutor/kujdestari, këtu e bashkangjitur dhe e shkarkueshme nga faqja e internetit të shoqatës, duke shtuar :



**Un Dentista per Amico**

**ArKe`Onlus**

- **Lista e gjithë të miturve të pranishëm në familje**( me datën e lindjes dhe shënime në rast problemesh ose sëmundje te veçanta)pavarësisht nga nevoja e supozuar për prespektivën e parandalimit .
- **Të gjitha të dhënat në lidhje me familjen (emri, adresa, kontaktet)**, duke mos harruar senjalizimin e emrit të dentistit që ka kuruar familjen me përpara, mënyren e transportit në studion dentare ( me trasporte publike ose me makinë) , praninë e sëmundjeve të rënda të pjestarëve familjar që parandalojnë shoqërimin e të miturit edhe informacione të tjera të dobishme .
- **Referencat e punonjësit social që sinjalizon mënyren per ta kontaktuar me lehtë.**

Për të miturit e rakomanduar nga organizata të tjera ( Caritas, Kryq i Kuq , ose shoqata të tjera vullnetare ) , Arkè rezervon të drejtën e vlerësimit te gjëndjes së vështirësisë ekonomike të aplikantit.

### **ARKÈ KA DETYRË , PASI PRANOHET KËRKESA PËR KURAT DENTARE TË :**

- Kontrolluj / Gjykoje kërkesën
- Kërkojnë dentist në dispozicion
- Dërgoj e-mail dentistit me të gjitha të dhenat e te miturit
- Dërgoj e- mail punonjësit social me të dhenat e dentistit
- Kontaktoj familjen për ti njohur dhe për tu siguruar për informinin e sakte të përdorimit të shërbimit.
- Monitorojne procesin e trajtimit / kurimit

Normalisht kërkesat përpunohen më së shumti brënda dy javëve ; kështu që, nëse ata që kanë sinjalizuar të miturin nuk marrin dentistin brënda kesaj kohe , ju lutemi të kontaktoni Arkè për të kontrolluar statusin e praktikës .

### **ËSHTË DETYRA E PUNËTORIT SOCIAL :**

- **Në takimin e parë , të plotësoj lejen** duke dorezuar nje Kopje të rregullores pas leximit dhe shpjegimit te përbashket.



Un Dentista per Amico

ArKe`Onlus

- **Pas marrjes të e-mail për caktimin e dentistit , njoftohet familja per te lene takimin e parë në emer te Arkè, duke iu pershtatur disponibilitetin të dentistit maksimumi brënda një jave pas marrjes se njoftimit te caktimit te dentistit, sepse ai pret thirrjen dhe nuk duhet të mbetet i papërdorur. Vetëm për arsye serioze i mituri nuk mund te jet i pranishëm në takim , familja është e detyruar të telefonoj brënda 24-48 oreve. Ne rast vonese/ mungese , i mituri humb te drejten e trajtimit/ kurimit dentar.**
- **Ne prani të prindërve te përshtatshëm :** mbikqyr përparimin e trajtimeve/ kurave deri ne perfundimin e tyre.
- **Ne prani të prindërve të papershtatshëm :** të shtojpjesëmarrjen e një edukatori ose një personi të besuar në familje i cili mund të kujdeset për shoqërimet nepërtakime. Personit do ti shpjegohet projekti dhe do ti lihet kopja e rregullores.
- **Duhet te raportoni te Arkè për çdo situatë problematike** që mund të krijohet ( prindi që nuk iu përgjigjet në telefon për muaj të tërë punonjesve social , pacientet që nuk përdonin dentistin ose e përdorin me kalimin e kohes në mënyre të pavarur domethënë pa përsëritur kërkesën në Arkè për kontrollin e ardhshëm etj ).
- **Të dergoj kërkesen Arkès sa herë që është e nevojshme një vizitë** ose te pakten një here në vit, madje edhe për të mitur të sinjalizuar tashmë në të kaluarën të cilët duhet të kontrollohen ne mënyrë periodike per masat parandaluese. Nuk lejohet të kontaktoni dentistin në mënyrë autonome sepse ndërkohë ai mund te jetë i angazhuar me pacient te tjerë ose për arsye te tjera është i padisponueshëm.
- **Të informoj Arkè për transferimin e mundshëm e të miturin** tësinjalizuar, ngafamiljanënjëstrukturetëmbrojtur.

### **ËSHTË DETYRË E PRINDIT / EDUKATORIT/ KUJDESTARIT:**

- **Të plotësoj lejen** me kujdes dhe në detaje ( firma ne fletën e lejes konfirmon pranimin e rregullores në të gjitha pikat e saj ).

Corso Angelo Gianelli, 38/4 16043 CHIAVARI (GE) | Tel: 0185 599487-347 9602102 | Fax: 0185 376315  
[info@associazionearke.it](mailto:info@associazionearke.it) | Pec: [udentistaperamico@pec.it](mailto:udentistaperamico@pec.it) | [www.associazionearke.it](http://www.associazionearke.it)

**Firma il tuo 5x1000 ad Arkè - C.F. 91038960109**



Un Dentista per Amico

ArKe`Onlus

- **Të paraqitet përballë punonjësit social**, që është përgjegjës për të marrë referencat e dentistit të caktuar i cili do të kujdeset për kurat falas dhe do të jetë i disponueshëm të caktoj datën e vizitës së parë në bazë të mundësive dhe programit të tij.
- **Respektoj takimet.** Me përjashtim, vetëm për arsye serioze, nëse i mituri nuk mund të prezantohet në takim , familja është e detyruar të njoftojë brenda 24-48 orë para takimit. Në rast vonese ose mungese i mituri humbet të drejtën e kurimit falas. Në rastin e një familje të madhe , të gjithë vëllezërit gjithashtu humbasin të drejtën e kurimit falas.
- **Pacienti ( edhe pse është 17 vjeçar ) duhet të shoqërohet** në të gjitha takimet ne studion dentare paraprakisht dhe higjenikisht i gatshëm për vizitë.  
Në studion dentare duhet të mbahet një **rregulli duhur** duke shmangur sjelljen e kafshëve , ushqimit dhe pijeve, pajisje elektronike ( telefona celularë ose cfarëdo).  
Një shënim i veçantë duhet ti kushtohet përdorimit të **cellularit i cili duhet të fiket para hyrjes ne studio, edhe ne dhomën e pritjesose do ishte më mirë të lihet në shtëpi.**
- **Të informoj dentistin për gjendjen shëndetësore te përgjithsme të pacientit** dhe për patologjitë e veçanta si allergji, hepatit, sindroma HIV të cilat do komunikohen
- vetëm mjekut duke respektuar privacy e pacientit.Për këtë qëllim është e nevojshme që pacienti të ketë librezën shëndetësore me vete.
- **Në rast që keni motra/ vëllezër , pasi të mbaroje trajtimi/ kurimi i të miturit të parë, vetëm atëherë mund të marrë takim për të dytin edhe keshtu me rradhe.**  
**Çdo studio dentare trajton vetëm një të mitur me rradhë,** por për më shumë të mitur në të njëjtën kohë duhet të jetë dentisti ta vendosi.
- Kontaktoni Arkè nëpërmjet punonjësve social për të marrë një takim për **vizitëkontrolli** mbas një viti nga përfundimi i trajtimit/ kurimit te pacientit, , nuk duhet shkuar tek dentisti në mënyrë autonome.



Un Dentista per Amico  
ArKe`Onlus

- **Mos merrni iniciativë të kërkoni asnjë lloj trajtimi.** Dentisti do të vendos vetë cilat **trajtime** i nevojiten pacientit ( nuk ka trajtime estetike, proteza dhe ortodontike) duke informuar pacientit dhe shoqëruesin. Shoqësuesit e rritur nuk mund të kërkojnë shërbime falas ose me pagesë , as për vete as për të tjerët.
- **Komunikoni përfundimin e trajtimit Arkès** , që në këtë mënyrë mund të dërgoj një pacient tjetër dentistit tashmë të lirë.

### **PACIENTI HUMBET TË DREJTËN E TRAJTIMIT FALAS NË RASTET NË VIJIM :**

- Vonesë të përsëritur ose mungesë në takim
- Higjene e dobët pas trajtimit dhe këshillat që kanë marrënga dentisti.
- Mungesa e shoqërimit nga edukatori
- Mospërdorimi i dentistit me kalimin e kohës
- Mungesë komunikimi të problemeve në marrëdhënie me studion dentare

### **FOKUS NË ORTODONTI ( konsulenza dhe pajisje ortodontike):**

Fusha e odontologjisë sociale e një OdV duhet të sigurojë shërbimet themelore .

Ortodontia është njëtrajtim/ kurim super i specializuar ( ndjek trajtimin dentar dhe është shpesh estetike jo funksionale) .

Ortodontët që aplikojne aparate dhëmbësh qëndrojnë të angazhuar të paktën një vit, ndonjëherë dy ose tre.

Gjatë kësaj kohe ata mund të ofrojnë trajtime/ kurime themelore për shumë të mitur që nuk do ngelen pa dhëmbë kur të rriten.

Fëmijët dhe adoleshentët tanë :

- Kanë shpesh një higjenë të keqe të gojës dhe janë vetë ortodontët që sygjerojnë mos aplikimin e aparatit të dhëmbëve për të shmangur formimin e madh të karieseve. Aparati i dhëmbëve mban ushqimin në kontakt me dhëmbëve tuaj edhe nëse nuk mbani një higjenë orale të përsosur , kur dentisti heq aparatin, shumica janë me karie/ kalbur.



Un Dentista per Amico

ArKe`Onlus

- Ata nuk vendosin në mënyrë të vazhdueshme aparatin e levizur, e thyejne ose e humbasin dhe nuk interesohen për aparatin fiks.
- Kur dalin nga struktura edhe kthehen në familje me aparatin e dhëmbëve, ata shpesh nuk prezantohen ne takimet e kontrollit mujor, pa njoftuar studion dentare, nuk shkojne të shoqëruar nga një i rritur ne takimet, etj...
- Nëse janë të huaj, edhe kanë aparat dhëmbësh të aplikuar jashtë shtetit, në spital ose në studio private, duke mos qënë në gjendje të përballojnë shpenzimet me kalimin e kohës , mund të kërkojnë Arkè të marrë përgjegjësinë, ose i aplikohet një aparat dhëmbësh në Itali dhe më pas kthehen në vendin e tyre me aparatin e ri pa dhënë informacione.

Duke marrë parasysh përvojat e cekura më lart, mbasi kemi bërë 500 konsultime dhe aplikuar 400 aparate për dhëmbët , që nga viti 2013 Arkè ka vendosur të përjashtoj ortodontinë nga shërbimet dentare falas.

**Shënim :**

**Dentistët tanë janë vullnetarë që bëjnë punen e tyre falas dhe nuk marrin para as nga Arkè as nga organe të tjera.**

**Ata meritojnë të gjithë simpatinë, respektin dhe mirënjohjen tonë!**